

AKT THEMELIMI

i

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ Bio-Mat”

Sot dt.06.01.2020, z.Afrim Stafasani, shtetas shqiptar, i datëlindjes 27.12.1967, lindur nëBurrel dhe bamies nëBurrel, person madhor e me zotësi për të vepruar, me nr.personal në ID : G71227064A, vendosi të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar dhe në përputhje me dispozitat vijuese.

Neni 1 Themelimi

Emri tregtar i Shoqërisëështë : Bio-Mat

Nëç gjitha aktet që dotë nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyruesisht emri “Bio-Mat”, sipas përcaktimeve të bera në këtë akt themelimi si dhe në statutin vijus.

Neni 2 Qëllimi i krijimit të shoqërisë

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme, të cilat do të përcaktohen në Statusin e saj. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

Neni 3 Emri dhe vula e shoërisë

Shoqëria do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin “Bio-Mat”. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

Neni 4 Objekti i veprimtarisë

Shoqëria dotë kryejë tëgjithaaktivitetetqënjeshoqëri me përgjegjësitëkufizuar mundtëushtrojë nëbazëtëlegjislacionitshqiptar, dhe nëveçanti:

- Tregtim i produkteve mjekesore veterinarë
- Tregtim i artikujve të ndryshëm
- Thertore dhe tregim i produkteve të mishit ;

Neni 5
Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në : Diber, Koms, Rruga nacionale Burrel-Bulqize, Km 2, Objekt ne Zonen Kadastrale 1325, me Nr.Pasturie 468/38

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një alat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit.

Neni 6
Kapitali i Shoqërisë dhe Ortakët

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë, i ndarë në 1 kuota me vlerë nominale të një kuote prej 100,000 lekë.

Ortakët themelues të Shoqërisë "Bio-Mat", zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë :
Z.Afrim Stafasani, lindi në Burrel më 27.12.1967, është zotëruar i 100% (njëqind për qind) i kapitalit (kuotave) të Shoqërisë ;

Kapitali themelues është shlyer plotësisht në para nga ortakët me themelimin e Shoqërisë.
Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributeve të tyre në kapitalin themelues.

Neni 7
Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë :

Asambleja e Përgjithshme e ortakëve – organ më i lartë vendimarrës ;


Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Neni 8
Administratori

Shoqëria administrohet nga Administratori i cili zgjidhet për një mandat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqërisë dotë jetë Z.Afrim Stafasani. Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretë nga Administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statusin e shoqërisë dhe legjislativin në fuqi.

Neni 9
Të tjera

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre për pjesëmarrjen në shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloji aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kulturimeve të përcaktuara në ligj.



- 7.1 Kuotat e kapitalit të Shoqërisë mund të rëndohen lirisht me banë siguruese apo të drejta të tjera reale.

KREU III Ndryshimi i kapitalit

Neni 8

- 8.1 Zmadhimi i kapitalit themeltar me anën e kontributeve në natyrë apo zvogëlimi i tij bëhet me miratimin e Ortakut të Vetëm mbi bazën e një projekti të paraqitur nga Audituesi Ligjor dhe me kërkesën e Ortakut të Vetëm apo Administratorit të Shoqërisë.
- 8.2 Zvogëlimi i kapitalit themeltar, bëhet në bazë të dispozitave të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 9 Zmadhimi i kapitalit

- 9.1 Ortaku i Vetëm, mund të vendosë që rritja e kapitalit të bëhet dhe me rezervat dhe fitimet e pashpërndara të shoqërisë, gjendje të cilat figurojnë deri në datën 31 dhjetor të vitit/viteve financiar/financiare paraardhës/paraardhëse. Kjo gjë bëhet vetëm pasi Ortaku i Vetëm, me vendim të ketë miratuar llogaritë vjetore të shoqërisë për vitin/vitet e mbyllur/mbyllura financiar/financiare paraardhës /paraardhëse.
- 9.2 Pas marrjes së një vendimi të tillë, Ortaku i Vetëm cakton një ekspert kontabël të regjistruar për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit themeltar me rezervat dhe fitimet e pashpërndara të shoqërisë, gjendje të datës 31 dhjetor të vitit paraardhës.
- 9.3 Pas prezantimit të aktit të vlerësimit nga eksperti kontabël i regjistruar, ortaku i vetëm i shoqërisë, me një vendim tjetër, përcakton mënyrën e rritjes së kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 9.4 Pas marrjes së vendimit të dytë nga Ortaku i Vetëm, e gjithë procedura e ndjekur uë zbatim të këtij neni do të deponohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

KREU IV Organizimi i shoqërisë Neni 10 Strukturat drejtuese dhe vendimmarrëse



- 10.1 Shoqëria tregtare "Bio-Mat" SHPK ka si struktura drejtuese dhe vendimmarrëse :
- Ortaku i Vetëm si organi vendimmarrës për shoqëriinë;
 - Administratorin

Neni 11

Defyrat dhe përgjegjësitë e organit vendimmarrës

- 11.1 Ortaku i Vetëm, si organ vendimmarrës për shoqëriinë, është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqëriinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkatkimit të administratorëve;
 - ç) emërimin e shkatkimit të likuiduesve dhe të Audituesve Ligjor;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "e" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 11.2 Ortaku i Vetëm merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës "1" të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.
- 11.3. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm do të regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Forma e regjistrit dhe mbajtja e vendimeve përcaktohen me vendim të ortakut të vetëm. Ortaku i vetëm, me vendim, mund të ngarkojë dhe një person fizik për mirëmbajtjen e regjistrit të mbledhjeve.
- 11.4 Nga ana e Ortakut të Vetëm merren të gjitha masat përkatëse për regjistrimin e vendimeve të saj pranë organeve përkatëse shtetërore dhe sidomos në veçanti, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investime;
 - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - d) vendimet e marra në zbatim të nenit 9 të këtij statuti.

- 11.5 Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka finar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 12

Mbledhja e organit vendimmarrës

- 12.1 Mbledhja e Ortakut të Vetëm zhvillohet në rastet e përcaktuara nga Ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 i ndryshuar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e ortakut të vetëm thirret dhe zhvillohet të paktën një herë në vit.
- 12.2 Mbledhja e Ortakut të Vetëm thirret nga kryesisht nga ortaku i vetëm, administratori apo dhe nga Audituesi Ligjor kur ka nevojë për diskutime për çështje ekonomike që lidhen me shoqërinë.
- 12.3 Mbledhja e Ortakut të Vetëm thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktiver e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (tre) muajve në vazhdim.
- 12.4 Mbledhja e Ortakut të Vetëm thirret nga personat e tjerë të parashikuar nga pika 12.2 e këtij neni jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar në mbledhjen e Ortakut të Vetëm. Mënyra e thirrjes së mbledhjes kryhet sipas përcaktimeve përkatëse të parashikuara Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

KREU V

Ortaku i vetëm, financimet

Neni 13

Ortaku i vetëm

- 13.1 Ortak i Vetëm i Shoqërisë është Z. Afrim STAFASANI, i datëlindjes 27.12.1967, lindur në Burrel, me nr.personal në ID : G71227064A, banues në Burrel, Shqipëri.

Neni 14

Vendimet e ortakut të vetëm

- 14.1 Ortaku i Vetëm, në përputhje me legjislacionin shqiptar merr vendime në lidhje me: (i) ndryshimin e këtij Statuti, (ii) zmadhimin e zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, (iii)



kalimin e kuotave të Shoqërisë, (iv) emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve si edhe emërimin e shkarkimin e ekspertit(ëve) kontabël të autorizuar, (v) miratimin e bilancit vjetor të Shoqërisë si edhe të çdo raportit tjetër financiar, (vi) shndërrimin, shpërndarjen dhe likuidimin e Shoqërisë, (vii) emërimin e likuidatorit(ëve) dhe çdo vendim tjetër që sipas ligjit i takon Ortakut të Vetëm.

- 14.2 Vendimet e Ortakut të Vetëm duhet të merren me shkrim dhe të regjistrohen në regjistrin e mbajtur pranë selisë së Shoqërisë.

Neni 15

Të drejtat dhe detyrat e ortakut të vetëm

- 15.1 Të drejtat dhe detyrat e ortakut të vetëm janë:

- Të marrë pjesë në mbledhjet e Ortakut të Vetëm;
- Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë;
- Të informohet mbi përmbajtjen e raportit të administrimit, inventarët e llogaritë vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, si dhe raportin e ekspertit kontabël;
- Të përfitojë nga fitimi i shoqërisë;
- Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara;

Neni 16

Financimi i shoqërisë

- 16.1 Organi i Administrimit të Shoqërisë, në përputhje me dispozitat në fuqi, përveç rasteve të zmadhimit të kapitalit, ka të drejtë të kërkojë nga ortaku i vetëm i shoqërisë fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë.
- 16.2 Financimet e mëtejshme të ortakut në shoqëri do të jenë me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të lëvrohen këto fonde.

KREU VI

Administrimi i shoqërisë

Neni 17

Administrimi i shoqërisë

- 17.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator i cili emërohet nga ortaku i vetëm për një periudhë pesëvjeçare, me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë i Shoqërisë emërohet:
- **Z.Afrim Stafasani**, i datëlindjes 27.12.1967, lindur në Burrel, me nr.personal në ID : G71227064A, banues në Burrel, Shqipëri.




- 17.2 Në zbatim të këtij neni, administratori i vetëm përfaqëson Shoqërinë kundrejt palëve të treta, përfshirë autoritetet publike dhe private, vendase ose të huaja, bankat, autoritetit tatinore dhe gjyqësore. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë sipas këtij akt themelimi dhe statuti e legjislacionit shqiptar.
- 17.3 Administratori mund të ndërmarrë apo kërkojë kryerjen e të gjitha akteve që konsideron të nevojshme për aritjen e objektit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakut të Vetëm apo organeve të tjera të Shoqërisë.

Neni 18

Të drejtat dhe detyrat e administratorit

- 18.1 Administratori ka këto të drejta dhe detyrohet të:
- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimitarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimitarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Ortakut të Vetëm për miratim;
 - krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarrëvajtjen e veprimitarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në Ligjin Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
 - raportoje përpara Ortakut të vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimitarinë e shoqërisë tregtare;
 - përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët;
 - kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 18.2 Administratori ka këto përgjegjësi :
- Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj sShoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që bën marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse ;



b) Përveçse sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet

1. a. Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedi ;
b. Të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të parashikuara në këto dispozita ;
c. Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim ;
d. Të mënjanëjë dhe të parandalojë rastet e konfliktit , prezenit apo të mundshëm, të interesave personale me ato të shoqërisë ;
e. Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori gjatë kryerjes së detyrës së tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerëimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ti kalojë çdo fitim personal ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka bariën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë Shoqërisë dëmat e shkaktuara, nëse në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme :
 - a. U kthen ortakëve kontributet ;
 - b. U paguan ortakëve interesa apo dividend ;
 - c. U shpërndar aktivet e shoqërisë ;
 - d. Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur në bazë të gjendjes financiare, duhet të parashikohet që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet ;
 - e. Jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiarë, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 19
Përgjegjësia e administratorit

- 19.1 Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Neni 20
Shpërblimi i administratorit

- 20.1 Ortaku i Vetëm përcakton shpërblimin e Administratorit të shoqërisë.

KREU VII
Kontrolli i kontabël i shoqërisë, Viti financiar dhe bilanci

Neni 21
Kontrolli kontabël

- 21.1 Kontrolli i jashtëm kontabël i Shoqërisë kryhet nga Auditues Ligjor, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Ortaku i Vetëm do të emërojë një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.
- 21.2 Për kompetencat, detyrimet, përgjegjësitë, zëvendësueshmërinë, tërheqjen, shkarkimin dhe shpërblimin i tij zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

Neni 22
Viti Financiar

- 22.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

Neni 23
Bilanci dhe rezervat

- 23.1 Me mbylljen e secilit vit financiar, Administratori merr masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur, në mënyrë që Ortaku i Vetëm të vendosë mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.
- 23.2 Ortaku i Vetëm vendos mbi udarjen e dividendëve që rezultojnë si fitime sipas bilancit të miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma të jenë zbritur lumbjet e mundshme të viteve të mëparshme.

- 23.3 Ortaku i Vetëm në çdo moment mund të vendosë krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre.

Neni 24
Punësimi në shoqëri

- 24.1 Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës palë si dhe paga mujore në përputhje me legjislacionin shqiptar në këtë fushë.

KREU VIII
Prishja dhe njoftimet

Neni 25
Prishja dhe likuidimi i shoqërisë

- 25.1 Shoqëria mund të priset në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak, si në rast falimentimi, privim të të drejtave për të ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktorë të tjerë që nuk varen nga Ortaku i Vetëm.
- 25.2 Shoqëria hyr në fazën e likuidimit qysh në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi, Ortaku i Vetëm emëron një ose disa likuidatorë, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre. Shoqëria priset në këto raste:
- Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj ;;
 - Kur nuk mund të përmbyshet objekti për të cilin është krijuar shoqëria;
 - Me vendim të ortakëve;
 - Me vendim të Gjykatës
 - Shkaqe të tjera të parashikuara në ligj

Neni 26
Procedurat që ndiqen

- 26.1 Likuidimi i shoqërisë tregtare "Bio-Mat" SHPK vendoset nga Ortaku i Vetëm kur priset shoqëria.
- 26.2 Likuidimi i shoqërisë do të bëhet duke zgjedhur procedurën e zakonshme të parashikuar në Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 26.3 Në qoftë se Ortaku i Vetëm, për mbylljen e parashikuar, nuk mund të marrë vendim ose ai nuk pranon të miratojë llogaritë e likuiduesit vendimi merret nga Gjykata me kërkesën e likuiduesit ose çdo personi të interesuar.



- 26.4 Nëse nuk është proceduar si më sipër Gjykata me miratimin e Ortakut të Vetëm zbaton dispozitat ligjore dhe në se miratimi nuk është dhënë deri në secundën e parë gjyqësore ky miratim prezumohet i mirëqenë.
- 26.5 Në fund të procesit të likuidimit fshirret Ortaku i Vetëm për të vendosur në lidhje me bilancin financiar përfundimtar.

Neni 27 Njoftimet

- 27.1 Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nëse ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruarat prej tyre pranë Administratorit të Shoqërisë.
- 27.2 Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas Legjislacionit për nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruarat prej tyre.
- 27.3 Në rastin kur një kuotë zotërohet nga më shumë se një person, të gjitha njoftimet do të drejtohen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve të kuotës.

KREU IX Bashkimi dhe ndarja e shoqërisë

Neni 28

- 28.1 Shoqëria "Bio-Mat" SHPK me anë të bashkimit mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ato themelojnë që ushtron te njëjtin aktivitet.
- 28.2 Gjithashtu shoqëria "Bio-Mat" SHPK me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.
- 28.3 Në rast se operacioni përfshin krijimin e shoqërive të reja secila prej tyre themelohet sipas rregullave që i përkasin shoqërisë që do të krijohet.
- 28.4 Transferimi i plotë i aktivitetit të shoqërisë apo kontributi në aktiv të një shoqërie tjetër, veçanërisht me anë të procesit të bashkimit duhet të autorizohet nga Ortaku i Vetëm.

KREU X Dispozita përfundimtare



Neni 29
Ligji i zbatueshëm

- 29.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë dhe Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

Neni 30

- 30.1 Ky Statut përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale secili me të njëjtën vlerë ligjore. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë

Ortaku i Vetëm
i
Shoqërisë "Bio-Mat" shpk

Afrim STAFASANI



